

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 377/2009  
Prishtinë  
10 maj 2011

**Gjykata Supreme e Kosovës** ka mbajtur seancë sipas nenit 26 paragrafit (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 10 maj 2011, në ndërtesën e Gjykatës Supreme, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit, gjyqtares së EULEX-it Antoinette Lepeltier-Durel dhe gjyqtareve të Gjykatës Supreme të Kosovës Emine Mustafa, Marije Ademi dhe Nesrin Lushta si natore të kolegjit

Dhe me Znj. Valentina Gashi si procesmbajtëse,

Në prani të

Prokurorit Publik të Kosovës Jusuf Mejzini, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK)

Avokatit mbrojtës B.K.për të pandehurin **S.B.**,  
Avokatëve mbrojtës A.A.dhe Z.J.për të pandehurin **H.I.**,  
Avokatit mbrojtës A.I. për të pandehurin **B.B.**,  
Avokatit mbrojtës Sh.P.për të pandehurin **F.A.**,  
Avokatit mbrojtës S.M.për të pandehurin **F.A.1.**dhe

Z. R.B.si përfaqësues i palës së dëmtuar, kompania Xxx Bank Kosovë,

Në lëndën penale numër AP-KZ Nr. 377/2009 kundër të pandehurve:

**B.B.**, i lindur më xxx në xxx, Republika e Maqedonisë (IRJM) shqiptar i Kosovës, xxx, emri i babait Rr., mbiemri i vajzërisë i së ëmës H. R., numri i letërnjoftimit: xxx, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i xxx fëmijëve, xxx, me të ardhura të mesatare, nuk janë duke u zhvilluar procedura tjera penale kundër tij, vazhdimisht në paraburgim që prej datës 9 qershor 2008 në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;

**H.I.**, i lindur më xxx në xxx, Komuna e Vitisë, xxx, shqiptar i Kosovës, emri i babait N., mbiemri i vajzërisë i së ëmës Z. Sh., din shkrim dhe lexim, ka të kryer shkollën e lartë ekonomike, i martuar, baba i xxx fëmijëve, i papunë, me të ardhura familjare të dobëta, nuk janë duke u zhvilluar procedura tjera penale kundër tij, vazhdimisht në paraburgim që prej datës 9 qershor 2008 në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;

**F.M.**, i lindur xxx në xxx, Komuna e Vitisë, xxx, shqiptar i Kosovës, emri i babait R., mbiemri i vajzërisë i së ëmës S. Sh., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, ka xxx fëmijë, i papunë, me të ardhura mesatare, në paraburgim që prej datës 9 qershor 2008 deri më 15 qershor 2010 në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;

**F.A.**, i lindur më xxx në xxx, Komuna e Vitisë, xxx, shqiptar i Kosovës, emri i babait J., mbiemri i vajzërisë i së ëmës B. A., din shkrim dhe lexim, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i xxx fëmijëve, i papunë, me të ardhura të mesatare, nuk janë duke u zhvilluar procedura tjera penale kundër tij, i mbajtur vazhdimisht në paraburgim që prej datës 9 qershor 2008, aktualisht në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan;

**S.B.**, i lindur më xxx në xxx, komuna e Vitisë, xxx, shqiptar i Kosovës, emri i babait D., i nënës T. me mbiemër të vajzërisë A., din shkrim dhe lexim, ka të kryer shkollimin fillor, i martuar, baba i xxx fëmijëve, bujk, me të ardhura të dobëta familjare, nuk janë duke u zhvilluar procedura tjera penale kundër tij, në paraburgim nga data 9 qershor 2008 deri më 8 dhjetor 2010 në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;

**F.A.1.**, i lindur më xxx në xxx, me adresë të fundit në liri në fshatin xxx, Komuna e Vitisë, shqiptar i Kosovës, emri i babait M., emri i nënës N. me mbiemër të vajzërisë H., din shkrim dhe lexim, ka të kryer shkollimin fillor, i martuar, baba i xxx fëmijëve, i papunë, me të ardhura mesatare, nuk janë duke u zhvilluar procedura tjera penale kundër tij vazhdimisht në paraburgim që nga data 10 qershor 2008 në Qendrën e paraburgimit në Dubravë;

Në përputhje me Aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën nr. P. Nr. 516/08 të datës 16 mars 2009 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në të njëjtën ditë, **të pandehurit**

- [i] janë liruar nga akuza e “krimit të organizuar” të përcaktuar me Nenin 274 (1) të KPK-së;
- [ii] janë shpallur fajtorë për veprën penale të “Grabitjes” në kundërshtim me nenin 255 (2) lidhur me pikën (1) të KPK-së në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPK-së për të akuzuarit B.B., H.I., F.M., F.A. dhe F.A.1.dhe me ndihmën e S.B., sipas nenit 25 të KPK-së;
- [iii] i akuzuari B.B. është shpallur fajtor për veprën penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve” në kundërshtim të nenit 328 (2) të KPK-së;

### **Dhe janë dënuar si në vijim:**

I akuzuari **B.B.** është dënuar për veprën penale **Grabitje**, të kryer në bashkëkryerje, me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve dhe gjashtë (6) muajve [neni 38 i KPK-së dhe nenet 255 (1), (2) dhe 23 të KPK-së] dhe për veprën penale **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** me burgim në kohëzgjatje prej pesë një (1) viti [neni 38 i KPK-së dhe neni 328 (2) i KPK-së]; Gjykata e shkallës së parë i ka caktuar një dënim unik prej gjashtë (6) viteve sipas nenit 71 të KPPK-së;

I akuzuari **H.I.** është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve, i akuzuari **F.M.** është dënuar, me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe të akuzuarit **F.A.** dhe **F.A.1.** të secili prej tyre është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve dhe gjashtë (6) muajve, sipas neneve 38 të KPK-së dhe 255 (1) (2) dhe 23 të KPK-së;

Kurse i akuzuari **S.B.** është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe gjashtë (6) muajve sipas neneve 38 të KPK-së dhe 255 (1) (2) dhe 25 të KPK-së.

Aktgjykimi përfundimisht është marrë dhe i është dorëzuar palëve në mes të 14 dhe 18 shtatorit 2009. Në veçanti, avokatët mbrojtës S.M. (për **F.A.1n**), Sh.P. (për **F.A.n**), B.K. (për **S.B.**) dhe A.I. (për **B.B.**) e kanë pranuar aktgjykimin më 16 shtator 2009, kurse avokatit mbrojtës A.R. (për **F.M.n**) i është dorëzuar aktgjykimi më 17 shtator 2009; të pandehurve **F.A.1**, **F.M.** dhe **F.A.** u është dorëzuar aktgjykimi më 16 shtator 2009, kurse të pandehurve **B.B.** dhe **H.I.t** aktgjykimi u është dorëzuar më 18 shtator 2009 dhe fletë-dërgesa e **S.B.t** është pa datën e pranimit; gjithashtu Zyrës së Prokurorit të Qarkut në Prishtinë aktgjykimi i është dorëzuar më 16 shtator 2009.

**Avokatët mbrojtës** pesë nga gjashtë të pandehurve kanë paraqitur me kohë ankesat e tyre kundër aktgjykimin, avokati mbrojtës i **S.B.t** më 23 shtator 2009 dhe e regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 30 shtator 2009, avokati mbrojtës i **F.A.t** më 24 shtator 2009, avokati mbrojtës i **F.A.1.t** më 24 shtator 2009 dhe e regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në ditën në vijim, avokati mbrojtës i **H.I.t** më 28 shtator 2009, kurse avokati mbrojtës i **F.M.t** më 10 tetor 2009 vetëm i është përgjigjur ankesës së paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë.

Pretendohet se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe kundërshtohet dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve. Është propozuar që të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshohet aktgjykimi dhe të akuzuarit të lirohen nga të gjitha akuzat (avokati B.K. për **S.B.n**, avokatët A.A. dhe Z.J. për **H.I.n**, avokati A.I. për **B.B.** dhe avokati S.M. për **F.A.1.n**), të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe i akuzuari të lirohet (avokati Sh.P. për **F.A.n**) ose të refuzohet ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë (avokati A.R. për **F.M.n**).

**Prokurori i Qarkut në Prishtinë**, më 24 shtator 2009 është ankuar kundër aktgjykimit të shkallës së parë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, për shkak të dënimit dhe ka propozuar që aktgjykimi i kundërshtuar të priset dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, ose aktgjykimi të ndryshohet dhe të pandehurve t'i shqiptohet një dënim me burgim më i lartë se dënimi i tanishëm.

**Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK)**, në përgjigjen e datës 26 nëntor 2009 dhe të regjistruar në shkrimore e Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë ka shprehur mendimin se ankesat kundër aktgjykimit të shkallës së parë janë të bazuara dhe për këtë arsye ka propozuar që të ankesat të aprovohen dhe aktgjykimi të anulohet.

Në bazë të aktgjykimit me shkrim në lëndën P. Nr. 377/09 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 16 mars 2009 (e paraqitur në shkrimoren e asaj gjykate në të njëjtën ditë), ankesat e paraqitura me shkrim nga avokatët mbrojtës dhe Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë si dhe mendimin e ZPSHK-së, dosjet përkatëse dhe parashtrësat verbale të palëve gjatë seancës më 10 maj 2011, së bashku me analizën e ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës pas këshillimit më 10 maj 2011, lëshon këtë:

## **AKTVENDIM**

**Ankesat e paraqitura nga avokatët mbrojtës Av. A.I. për të pandehurin B.B., Av. A.A. dhe Av. Ž.J. për të pandehurin H.I., Av. Sh.P. për të pandehurin F.A., Av. B.K. për të pandehurin S.B. dhe Av. S.M. për të pandehurin F.A.1. , PRANOHEN. Ankesa e paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë, PRANOHET PJESËRISHT.**

**Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 516/2008, i datës 16 mars 2009, ANULOHET NË TËRËSI dhe lënda i KTHEHET gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.**

## **A R S Y E T I M**

### **Historia procedurale**

1. Në mëngjesin e datës 9 qershor 2008 në mes të orës 08:06:07 dhe 08:07:47, një veturë e gjelbër VW Golf me tabela regjistrimi të Kosovës xxx, e cila më vonë është konstatuar të jetë pronë e të pandehurit **S.B.**, i është afruar degës së Xxx Bank në Ferizaj dhe është parkuar pikërisht përballë hyrjes. Një person me rroba të zeza, me maskë dhe me dorëza të verdha doli nga vetura dhe u fut në objektin e bankës duke mbajtur në duar një revole. Personi tjetër me xhemper të kuq, i cili kishte po ashtu të veshura një palë dorëza ngjyrë të verdhë dhe në duar mbante një revole, doli nga vetura dhe gjithashtu u fut në bankë,

duke shkuar drejt në zyrën ku ndodheshin paratë, i mori dy thasë me para dhe doli përsëri nga banka. Pas kësaj, edhe personi i parë doli nga banka dhe të dy kryerësit braktisën vendin e krimit me veturën e tyre VW Gol me shpejtësi të madhe.

2. Që nga pjesa e fundit e shkurtit 2008, Policia e Kosovës kishte pranuar informata të zbulimit se i pandehuri **B.B.**, i cili në atë kohë po punonte si mbikëqyrës i sigurimit për kompaninë e cila ofronte ndihmë në sigurimin e objektit të Xxx Bankës, së bashku me persona të tjerë të panjohur ishte duke planifikuar të kryente një plaçkitje të bankës shumë shpejt, kur vetura e tij xxx, e ngjyrës së xxx u bastis të njëjtën ditë menjëherë pas incidentit ndërsa 15 fishekë të kalibrit 15mm u gjetën për fundi shtrojës për këmbë në anën e vozitësit nën pedale. Për më tepër, edhe më 9 qershor 2008 i pandehuri **B.B.** u kontaktua dhe u mor nga Policia e Kosovës në restorantin “xxx” në Ferizaj, ku thuhej se ai kishte qenë për pak kohë në mëngjes në mes të orës 08:00 dhe 09:00.

3. Dy ditë më vonë, më 11 qershor 2011, policia gjeti një revole të markës Ceska Zbrojevka, modeli VZOR 50 me 7 plumba të kalibrit 65x17 mm, me numër serik D-30238, të prodhimit çekoslovak, në koshin e plehrave në tualetin e restorantit “xxx”.

4. Duke i përcjellë lëvizjet e të pandehurit **B.B.**, policët fillimisht kanë përcjellë të pandehurin në një bar në Viti, ku ai u takua me të pandehurit **F.M.** dhe **F.A.**, dhe në atë rast i ka arrestuar të gjithë.

5. Duke u bazuar në informatat e siguruara nga i pandehuri **F.M.**, policia bastisi shtëpinë e këtij të fundit në fshatin xxx dhe për më tepër identifikoi **S.B.n** dhe **F.A.1n** si bashkëkryerës të veprave përkatëse penale.

6. Pas hetimeve të përfunduara, Prokurori publik i qarkut të Prishtinës ka paraqitur aktakuzën më 25 gusht 2008 (PP. nr. 465-6/2008) dhe ka akuzuar të pandehurit **B.B.**, **H.I.**, **F.M.**, **F.A.**, **S.B.** dhe **F.A.1** për kryerje të veprës penale të organizuar në përputhje me Nenin 274, par. 1 të KPPK-së, lidhur me Nenin 255, par. 2, në kuptim të paragrafit 1 të KPPK-së; dhe të pandehurin **B.B.** edhe për kryerjen e veprës penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, sipas Nenit 328, par. 2 të KPPK-së.

7. Aktakuza është konfirmuar më 20 tetor 2008 përmes Aktvendimit të Gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës së Gjykatës së Qarkut të Prishtinës (KA. Nr. 495/2008).

8. Më 15 janar 2009, shqyrtimi gjyqësor ka filluar në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës dhe janë mbajtur tetë seanca më datat 26 janar, 6 shkurt, 24 shkurt, 9 mars, 10 mars, 13 mars dhe 16 mars 2009, gjatë të cilave të pandehurit janë marrë në pyetje dhe kanë pasur mundësinë që të pranojnë fajin, shumë dëshmitarë janë dëgjuar, në veçanti Q.J.(kamerier në restorantin ‘xxx), A.L.(e cila kishte shoqëruar të pandehurin **H.I.** më 9 qershor 2008 në mes orës 10:45 dhe 12:00 gjatë një udhëtimi nga fshati i saj deri në Viti), D.P. (i cili është takuar me të pandehurin **H.I.** më 9 qershor 2008 rreth drekës), N.H.(bujk nga fshati xxx, komuna Viti, ku i pandehuri **S.B.** ishte duke banuar në kohën e veprës së përmendur penale), H.A.(pronar i dyqanit në të cilin i pandehuri **S.B.** blinte gjëra të ndryshme),

S.R.(Polic i Kosovës / Departamenti i forenzikës së Ferizajt), B.R.(Polic i Kosovës nga Ferizaj) dhe I.H.(Komandant rajonal i policisë në Ferizaj), pastaj është shikuar CD-ja e cila përmbante regjistrimin e plaçkitjes së bankës, të pandehurit **B.B., H.I., F.A., F.M., S.B.** dhe **F.A.I.** patën rastin të japin dëshmitë e tyre ndërsa u regjistruan edhe “dokumentet që do të shqyrtoheshin si prova të pranueshme”.

9. Duke u bazuar në gjetjet e saj më 16 mars 2009, Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin dhe ka shpallur fajtor të akuzuarin për veprat penale të përmendura nga pika [i] deri në pikën [iii]. Rrjedhimisht, gjykata ka shqiptuar dënimet ndaj të akuzuarve siç është thënë më lart.

10. Pasi është nxjerrë aktgjykimi, më në fund u është dërguar edhe palëve ndërmjet datave 14 dhe 18 shtator 2009. Për këtë arsye, **Avokatët mbrojtës të pesë nga gjithsej gjashtë të pandehurve me kohë kanë ushtruar ankesa kundër Aktgjyimit të shkallës së parë, ndërsa mbrojtësi i F.M.t është përgjigjur në ankesën e ushtruar nga Prokurori publik i qarkut të Prishtinës, siç është thënë edhe më herët në mes të 23 shtatorit 2009 dhe 10 tetorit 2009 në pajtim me Nenin 398, par. 1 dhe Nenin 399, par. 1 të KPPK-së – KPPK-së.**

11. **Prokurori publik i qarkut të Prishtinës** po ashtu me kohë ka ushtruar ankesë më 24 shtator 2009 ndërsa **ZPSHK-ja** ka dhënë mendimin dhe propozimin e saj më datën 26 nëntor 2009 pranë kësaj gjykate.

12. Më 10 maj 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën sipas Nenit 410 të KPPK-së.

13. Avokatët mbrojtës kanë konfirmuar qëndrimet dhe propozimet e tyre.

14. Prokurori publik ka konstatuar se ankesat duhet të miratohen ndërsa Aktgjykimi të anulohet.

### **GJETJET E GJYKATËS**

15. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se Aktgjykimi i kundërshtuar përmban një varg dobësish dhe dështimesh serioze materiale dhe ligjore.

#### **A. Lejueshmëria e ankesave:**

16. Gjykata Supreme e Kosovës fillimisht konstaton se të gjitha ankesat e mbrojtjes si dhe ankesa e Prokurorit publik të qarkut të Prishtinës janë të papranueshme në kuptimin e Nenit 398, par. 1 të KPPK-së, sipas të cilit “*Kundër aktgjyimit të marrë në shkallë të parë, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjyimit.*”

Gjykata Supreme në këtë kuptim e ka të qartë se – edhe pse aktgjykimi i kundërshtuar ishte shpallur më 16 mars 2008, Aktgjykimi i përpiluar me shkrim u ishte dorëzuar palëve tek midis 14 dhe 18 shtatorit të vitit 2008, pothuaj saktësisht gjashtë (6) muaj pas shpalljes së vendimit.

Asgjë nuk mund të thuhet lidhur me çështjen nëse Aktgjykimi ishte përpiluar me shkrim në pajtim me Nenin 395, par. 1 të KPPK-së, sipas të cilit *“aktgjykimi duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë ditë në raste të tjera.”*

Edhe pse në rastin në fjalë, është shqetësuese që gjatë tërë periudhës kritike pra nga shpallja e vendimit më 16 mars 2008 e deri në momentin kur Aktgjykimi në fjalë më në fund u ishte dorëzuar palëve pra diku midis 14 dhe 18 shtatorit 2008, të gjithë të pandehurit (të gjashtit) vazhdimisht kanë qenë në paraburgim, pra kanë qenë të privuar nga çdo mundësi për t'i shfrytëzuar mjetet e tyre ligjore të garantuara me ligj, shkresat e lëndës nuk ofrojnë asnjë informatë se kur është përpiluar me shkrim Aktgjykimi ashtu siç përcaktohet me ligj.

Përkundër kësaj, vonesa tepër e madhe e dorëzimit të aktgjykimeve tek palët nuk mund të konsiderohet të shkojë në dëm të të pandehurve.

## **B. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale**

17. Të gjashtë mbrojtësit e të pandehurve **B.B., H.I., F.A., S.B.** dhe **F.A.1.si** dhe Prokurori publik i qarkut të Prishtinës kanë kundërshtuar Aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale sipas Nenit 403, par. 1, pikës 12 të KPPK-së. Këto ankesa janë mbështetur edhe përmes mendimit të ZPSHK-së. Posaçërisht, dispozitivi i Aktgjykimit të kundërshtuar do të konsiderohej i ngatërruar, i pakuptueshëm dhe i paqartë, duke qenë kështu në kundërshtim me Nenin 391 të KPPK-së. Ky dispozitiv po ashtu do të ishte në kundërshtim me arsyetimin dhe me provat e mbledhura. Prandaj, do të ishte i pakuptueshëm edhe në tërësi si Aktgjykim, pasi që nuk do të kishte mundësi që të kuptohet se cilat veprime janë ndërmarrë nga i akuzuari gjatë kryerjes së veprës penale. Aktgjykimi, në përgjithësi nuk do të mbështetej më fakte relevante dhe për më tepër nuk do të përpilohej në përputhje me Nenin 396 të KPPK-së.

18. Për më tepër, mbrojtja e të pandehurit **S.B.** ka kundërshtuar këtë Aktgjykim, sepse deklaratimet e të pandehurit se ka qenë i keqtrajtuar nga policia gjatë fazës së procedurës paraprake nuk janë marrë parasysh fare nga Gjykata e shkallës së parë.

19. Sa i përket të pandehurit **B.B.**, mbrojtja ka theksuar se Aktgjykimi në këtë mënyrë do të ishte mbështetur vetëm në dëshmitë e të bashkëpandehurit **F.M.**, të dhëna para policisë më 10 qershor 2008 dhe para Prokurorit publik më 17 korrik 2008, që të dyja do të ishin të papranueshme sipas Neneve 156 dhe 157 të KPPK-së, pasi që as i pandehuri as avokati i tij mbrojtës kurrë nuk kishin pasur mundësinë të merrnin në pyetje dëshmitarët. Prandaj, Aktgjykimi do të ishte në kundërshtim edhe me Nenin 403, par. 1, pikën 8 të KPPK-së.

20. Po ashtu, përkitazi me të pandehurin **F.A.**, Gjykata e shkallës së parë – përkundër marrjes parasysh të dëshmive të bashkëpandehurit **F.M.** – nuk ishte marrë bile as mundimin e arsyetimit të fakteve në të cilat ishte mbështetur, kur e kishte shpallur të pandehurin fajtor.

#### **I. Pohimi mbi shkeljen e Nenit 403, par. 1, pika 12 e KPPK-së:**

21. Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se Aktgjykimi i kundërshtuar shkel në mënyrë të rëndë dispozitat e procedurës penale, në veçanti sipas Nenit 403, par. 1, pikës 12 të KPPK-së.

Një dispozitiv i kuptueshëm dhe me përmbajtje të qëndrueshme, i cili e konstaton të akuzuarin fajtor si në rastin në fjalë duhet të përmbushë kushtet ligjore të përcaktuara me Nenin 396, par. 3 deri në 5 dhe Nenin 391 të KPPK-së.

Neni 396, par. 3 dhe 4 të KPPK-së, të cilët kanë rëndësi për lëndën në fjalë, përcaktojnë si më poshtë:

#### ***Neni 396***

*(1)...*

*(3) Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (Neni 233, paragrafi 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza.*

*(4) Nëse i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit do të përmbaj të dhënat e nevojshme të specifikuar në nenin 391 të Kodit të tanishëm dhe nëse ai ose ajo është liruar apo akuza është refuzuar, dispozitivi do të përmbaj një përshkrim të veprës me të cilën ai ose ajo është akuzuar dhe vendimin në lidhje me shpenzimet e procedurës penale si edhe kërkesën pasurore juridike, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur.*

*(5)...*

Neni 391 paragrafi 1 i KPPK, relevant për lëndën në fjalë, përcakton si më poshtë:

#### ***Neni 391***

*(1) Në një aktgjykim që e shpall të akuzuarin fajtor, gjykata duhet të deklaroj:*

*1) Veprën për të cilën ai ose ajo është shpallur fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që tregojnë për natyrën kriminale të veprës së kryer, dhe faktet dhe rrethanat në të cilat varet aplikimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal;*



- 2) Përcaktimi ligjor i veprës dhe dispozitat e ligjit penal të zbatueshëm në kalimin e aktgjykimit;
- 3) ...

Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar – në kundërshtim me këto kërkesa të ligjit – përcakton si më poshtë:

## **GJYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS**

**P Nr. 516/08**

**Data 16 mars 2008**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

*Gjykata e Qarkut të Prishtinës, në trupin gjykues të përbërë nga ...*

*Në lëndën penale kundër*

**B.B., ...**

**H.I., ...**

**F.M., ...**

**F.A., ...**

**S.B., ...**

**F.A.I.; ...**

*Bazuar në nenin 391 (1) KPPK;*

*Shqipton hapur dhe në praninë e të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe të prokurorit publik këtë:*

### **AKTGJYKIM**

**1) të gjithë të akuzuarit e lartë përmednur**

**lirohen**

*nga akuza “krimi i organizuar” sikurse është përcaktuar në nenin 274 (1) të KPK;*

**2) Të gjithë të akuzuarit e lartë përmendnr**

**shpallen fajtor**

*për veprën penale “grabitje” në kundërshtim me nenin 255 (2) në lidhje me (1) KPK në bashkë-kryerje sipas nenit 23 të KPK për të akuzuarin B.B., H.I., F.M., F.A., dhe F.A.I. si edhe me ndihmën e S.B., në pajtim me nenin 25 të KPK;*

3) *I akuzuari B.B.*

**Shpallet fajtor**

*Për veprën penale “posedim dhe përdorim i paautorizuar i armëve” në kundërshtim me nenin 328 (2) të KPK;*

**DËNIMI**

**B.B.**

*Në pajtim me nenin 38 të KPK dhe neni 255 (1) (2) dhe 23 të KPK dënohet me burgim prej 5 (pesë) vite dhe 6 (gjashtë) muaj;*

*Në pajtim me nenin 38 të KPK dhe nenin 328 (2) të KPK dënohet me 1 (një) vit burgim;*

*Në pajtim me nenin 71 të KPK dënimi unik është 6 (gjashtë) vite burgim;*

**H.I. ...;**

**F.M. ...;**

**F.A. ...;**

**S.B. ...;**

**F.A.I....;**

*Për të gjithë të akuzuarit, koha e kaluar në paraburgim përfshihet në lartësinë e dënimit të shqiptuar për të gjithë të pandehurit.*

**KËRKESA PRONËSORE JURIDIKE ...**

**KOFISKIMI ...**

**SHPENZIMET ...**

Aktgjykimi i kundërshtuar pastaj vazhdon me arsyetimin.

22. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se ky dispozitiv nuk është në pajtim me ligjin në fuqi si është cituar më parë.

Pavarësisht se në kundërshtim me nenin 233 paragrafi 1 i KPPK të dhënat personale të të pandehurve nuk janë vërtetuar plotësisht sipas numrave të tyre personal të identifikimit, pyetja nëse janë ata janë të arsimuar dhe në qoftë se ka disa procedura të tjera penale në zhvillim e sipër kundër tyre, e të cilat të gjitha mund të qartësohen në rastin në fjalë duke pasur parasysh se identiteti i të pandehurve nuk është i diskutueshëm, është vërtetuar niveli i arsimimit të tyre shkollorë dhe procedurat penale të tjera të mbetura pezull mund të konsiderohen në një fazë të mëvonshme, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se

dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar nuk i plotëson kërkesat e nenit 391 paragrafi pika 1 e KPPK.

23. Në veçanti, asnjë informacion nuk është dhënë për faktet dhe rrethanat që tregojnë për natyrën kriminale të veprës së kryer, si edhe për të justifikuar zbatimin e dispozitave përkatëse të ligjit penal. Referencë e vetme për këto fakte dhe rrethana të kërkuara të bërë nga aktgjykimi i kundërshtuar mund të gjenden në f. 4-5 të versionit anglisht, ku në rrjedhën e arsyetimit aktvendimi përcakton se “[m]ë 25 gusht 2008, Prokurori Publik ka ngritur aktakuzë [...] kundër të pandehurve të përmendurë më lart për veprat penale në vijim: **I. B.B., H.I., F.M., F.A., S.B. dhe F.AI...** Kanë kryer krim të rëndë si pjesë e grupit të organizuar kriminal me qëllim të fitimit të drejtpërdrejtë financiare dhe materiale, në atë mënyrë që të pandehurit **B.B. dhe H.I.** paraprakisht kanë bërë një plan për të grabitur degën e ‘xxx Bankë’ në Ferizaj dhe pas bërjes së planit ata kanë kontaktuar me të pandehurin **F.M.** nga i cili kanë kërkuar për të gjetur një person të besuar që do të hyjë në bankë, së bashku me të pandehurin **B.**, prandaj i pandehuri **F.** ka kontaktuar me të pandehurin **Xh. A.**, i cili është në arrati. [...] që të katër [...] kanë ndarë rolet për njëri tjetrin [...] dhe për të pandehurit e tjerë [...] dhe [...] më 9 qershor 2008, në orën 08.06 minuta, me makinën ‘Golf 2’, ngjyrë e gjelbër me numrin e regjistrimit xxx, pronë e të pandehurit **S.B.**, i cili pas marrëveshjes me të pandehurit [...] e la makinën në oborrin e shtëpisë së tij, të hapur, me çelësat brenda [...]”.

Ky tekst, pavarësisht asaj se mezi është i kuptueshëm, por i cila më pas vazhdon me një përshkrim të detajuar të gjitha aspekteve të grabitjes të një banke dhe përfundon me shumën e të hollave gjoja të marra dhe të ndarë nga të akuzuarit, dhe së fundi trajton edhe përgjegjësinë penale të **B.B.** në lidhje me Posedim dhe Përdorim të Paligjshëm të Armëve, në mënyrë të qartë është një citat i pastër i aktakuzës dhe padyshim ishte kopje-ngjitje nga atje në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar.

Sigurisht, Gjykata Supreme e Kosovës në disa raste të mëparshme ka theksuar mendimin e saj se çdo aktgjykim duhet të lexohet si një dokument i tërë. Prandaj, ai jo domosdoshmërisht mund të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitivit ose aktgjykimit të tërë në fjalë, në qoftë se kufijtë ndërmjet hyrjes, dispozitivit të aktgjykimit, dhe arsyetimit të një aktgjykimi nuk janë tërhequr në mënyrë precise, për aq sa linja e argumentimit dhe fakteve të referuara është logjike dhe e qartë dhe pozita e gjyqtarit si organ vendim-marrës mund të kuptohet qartë nga ky dokument.

Megjithatë, kjo nuk është dhënë në lëndën në fjalë. Edhe pse aktgjykimi i kundërshtuar në fund, në thelb, e shpall të pandehurin fajtorë për Grabitje sipas nenit 255 të KPK-së të kryer në bashkë-kryerje dhe të pandehurin **B.B.** ndaras për Posedim dhe Përdorim të Paautorizuar të Armëve në pajtim me nenin 328 paragrafi 2 të KPK-së dhe në këtë mënyrë në përputhje me akuzat e aktakuzës, nuk mund të kuptohet pa dyshim që pozita e Prokurorit Publik të përcaktuara në aktakuzë është identike me atë të marrë nga gjyqtari. Në këtë aspekt veçanërisht është me rëndësi fakti se gjykata e shkallës së parë i ka liruar të gjithë të pandehurit nga akuzat në lidhje me kryerjen e Krimit të Organizuar sipas nenit 274 të KPK-së. Mbi sfondin e këtij aktvendimi del se gjykata e shkallës së parë nuk e ka ndarë qëndrimin e Prokurorit Publik për 100%.

Prandaj, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është jo i plotë dhe prandaj i pakuptueshëm si edhe kundërthënës në brendinë e tij.

24. Për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i kundërshtuar në pjesë të mëdha është kundërthënës dhe për këtë arsye i paqartë. Arsyetimi i aktgjykimit deri në një sasi të madhe të tekstit përbëhet nga fragmente kopje-ngjitje nga disa procesverbale të marra gjatë shqyrtimit kryesor dhe më pas vjen në përfundime të caktuara, por pa reflektuar mbi përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve të cituar ose deklaratat e të pandehurve të referuar për çështjet e besueshmërisë dhe atribuimit në kuadër të vëzhgimeve të tjera të ndryshme, deklaratave apo dëshmive të tjera. Prandaj, në këto raste konkludimet e arsyetimit nuk mund të lidhen logjikisht me dokumentet e cituar.

Për shembull, në kontekstin e dhënë, referenca i është bërë vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me pjesëmarrjen e të pandehurit **B.B.** në grabitjen e bankës (f.14-15 e versionit në gjuhën angleze), ku në fund të citimit të procesverbalit mbi marrjen në pyetje të **B.B.** nga Prokurori Publik është thënë:

*“Prokurori Publik: Një armë është gjetur në shportën e mbeturinave mbrenda ‘xxx’. Është prodhim Çek, a është e jotja?*

***B.B.:** Nuk është e imja”.*

Gjykata e shkallës së parë, në vend të reflektoj mbi aspektet e besueshmërisë dhe atribuimit të pandehurit dhe deklaratës së tij në këtë aspekt, pastaj vetëm vazhdon duke theksuar se *“[një] pjesë tjetër inkriminuese e rëndësishme e provave përbëhet nga rezultatet e regjistrimit të thirrjeve telefonike, të cilat kanë treguar se **B.B.** ra në kontakt me **H.I.n** në pasditën dhe natën para ditës kritike dhe të njëjtën ditë më 9 qershor 2008”.* Pastaj vijon një listë e thirrjeve përkatëse, por natyrisht pa dhënë ndonjë informacion lidhur me përmbajtjen e tyre.

25. E njëjta vlen për akuzën Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së kundër të pandehurit **B.B.**. Pas citimit të procesverbalit përkatës në lidhje me gjetjen dhe pronësinë e revoles, përsëri gjykata e shkallës së parë vetëm vazhdon me konkludimin se *“[në këtë mënyrë], elementi material (actus rei) vërtetohet me anë të rrethanave faktike se revolja e përdorur gjatë grabitjes dhe pesëmbëdhjetë (15) plumbat janë gjetur në shportën e mbeturinave të restorantit “xxx” dhe në veturën e tij Alfa romeo me ngjyrë të kuqe, pas bastisjes së ligjshme dhe konfiskimit nga ana e policisë”.*

Në lidhje me këto të dyja, asnjë fjalë nuk është shpenzuar lidhur me pyetjen nëse 15 plumbat përkatës nga vetura e të pandehurit, të cilat gjoja ka qenë të kalibrit 15 mm, kanë qenë të përshtatshëm për revolen nga shporta e mbeturinave, e që kjo e fundit ishte e markës ‘Ceska Zbrojevka’ modeli VZOR 50 7, 65 x 17 mm kalibrit. Gjithashtu nuk i është kushtuar vëmendje faktit se sipas deklaratës së dëshmitarit Q.J.i cili punonte si kamerier in restorantin ‘xxx’, kur i pandehuri **B.B.** ka qëndruar aty më 9 qershor 2008, ky

i fundit kishte qenë i ulur në tavolinën e tij dhe asnjëherë nuk kishte shkuar në tualet dhe se shportat e mbeturinave zbrazeshin dy herë në ditë, kurse revolja përkatëse është gjetur dy ditë pasi që i pandehuri kishte vizituar restorantin (faqet 12-13 të versionit në gjuhën angleze).

Veçanërisht kjo provë ka mundur të përdoret si provë vërtetuese në lidhje me pjesëmarrjen e pretenduar të të pandehurit **B.B.** në grabitjen e bankës, pasi që në bazë të analizave të video incizimeve vetëm nga banka nuk ka qenë e mundur që personalisht të identifikohen dy grabitësit, të cilët që të dy mbanin revole gjatë aksionit (faqe 11-12 e versionit në gjuhën angleze).

26. E fundit por jo më pak më e rëndësishme vlen të përmendet se citimi i protokollit të përgjimeve, e që këtë të fundit e përmban aktgjykimi i kundërshtuar në rreth gjashtë (6) faqe, gjithashtu në lidhje me të pandehurit e tjerë, nuk ofrojnë së paku prova të forta vërtetuese, duke e marrë parasysh se përmbajta e këtyre kontakteve telefonike nuk është e njohur dhe se popullata në Kosovës zakonisht komunikojnë përmes telefonave mobil, shumë më shumë se që mund të përdoren në shtetet tjera. Prandaj, jo domosdoshmërisht mund të arrihet të konkludimi nga këto rezultate të përgjimeve në lidhje me koordinimin e pretenduar të grabitjes së bankës

Vlen të përmendet se gjykata e shkallës së parë ka bazuar mendimin e saj dhe tërë aktgjykimin gati në vetëm deklaratat e të bashkëpandehurit të dhënë në polici më 10 qershor 2008. Përkundër pyetjes, nëse kjo deklaratë është dëshmi e pranueshme (e cila do të adresohet më vonë), besueshmëria e dëshmitarit dhe besueshmëria e deklaratës nuk janë analizuar dhe vlerësuar asnjëherë në dritën e provave tjera.

27. Dobësitë e tjera të aktgjyimit të kundërshtuar në lidhje me këtë vetëm do të përmbliidhen në interes të ofrimit të udhëzimeve për gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Ashtu ishte edhe dëshmia përkatëse e **F.M.t** e dhënë më 10 qershor 2008 në polici, fjalë për fjalë e cituar tri herë në aktgjykimin e kundërshtuar (faqe 16-17 të versionit në gjuhën angleze në kontekstin e përgjegjësisë penale të **B.B.**, faqe 24-25 të versionit në gjuhën angleze në kontekstin e përgjegjësisë penale të **H.I.t** dhe faqe 26-27 të versionit në gjuhën angleze në kontekstin e përgjegjësisë penale të vetë të pandehurit **F.M.t**) si dhe e përdorur në lidhje me përgjegjësinë penale të **F.A.t**, mirëpo pa analiza të duhura dhe reflektim të dëshmive në dritën e provave tjera.

28. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka përfituar nga rasti që ta kuptojnë dëshminë e pohuar të dëshmitarit **S.B.** i cili sipas mbrojtjes së tij është abuzuar nga policia gjatë fazës së hetimeve, duke e shtyrë atë që të shkojë në stacionin e policisë në bagazhin e veturës së policisë. Sidoqoftë, Gjykata Supreme në këtë kontekst vëren se në të vërtetë gjykata e shkallës së parë nuk ka përmendur asnjë fjalë lidhur me çështjen, e cila mund të jetë me rëndësi të madhe kur bëhet fjalë për vlerësimin e dëshmive të policëve përkatës si dhe vlerësimin e dëshmive të vetë të pandehurve gjatë fazës së hetimeve dhe fazës së procedurës paraprake.

## II. Shkelja e pretenduar e nenit 403 paragrafit 1 pikës 8 të KPPK-së:

29. Sa i përket pyetjes së përgjithshme lidhur me pranueshmërinë e dëshmisë së të pandehurit **F.M.t** në kuptim të neneve 156 dhe 157 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka përfituar nga rasti që të shkojë më thellë në detajet relevante, në këtë mënyrë duke i kontrolluar të gjitha shkresat e lëndës për informata lidhur me çështjen, duke e marrë parasysh shkeljen e qartë më të rëndë tanimë të vërtetuar të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së.

Sidoqoftë, në rast se del se në të vërtetë mbrojtja dhe të pandehurit kurrë nuk kanë pasur mundësinë që ta marrin në pyetje **F.M.n** në lidhje me pyetjet dhe aspektet siç janë adresuar në dëshminë e tij të datës 10 qershor 2008 (dhe gjithashtu më 17 korrik 2008), kjo provë do të duhej të shënohej dhe trajtohej si provë e papranueshme në kuptim të neneve 156 dhe 157 të KPPK-së.

### C. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

30. Avokatët mbrojtës të të pandehurve **B.B., F.A., S.B., H.I.** dhe **F.A.1.** kanë kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë gjithashtu edhe për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkelje të nenit 402 paragrafit 1 pikës 3 në lidhje me nenin 405 të KPPK-së. Aktgjykimi nuk ka konsideruar faktin se të gjithë të pandehurit kanë mohuar pjesëmarrje e tyre në kryerjen veprës penale përkatëse grabitjes së bankës.

31. Në lidhje me të pandehurin **B.B.**, gjykata e shkallës së parë në veçanti nuk ka vërtetuar se i pandehuri ka mbajtur armë pa autorizim. Për më tepër, ai as nuk i ka njohur të bashkëpandehurit e grabitjes së pretenduar **Xh. A., F.M., S.B.** dhe **F.A1..**

32. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh se i pandehuri **H.I.** sipas dëshmisë së tij dhe dëshmimeve të dëshmitarëve asnjëherë nuk kanë kontaktuar të pandehurin **F.M.n** dhe se në veçanti ai nuk i ka dhënë asnjë udhëzim të bashkëpandehurve të tjerë në lidhje me grabitjen e bankës. Në vend të kësaj ai kishte fjetur deri në ora 08:00 më 9 qershor 2008 dhe ka qëndruar në shtëpi deri në ora 11:00, kur ai ka dalë për kafe me dëshmitarët **A.L.** dhe **D.P.**. Asnjë provë tjetër nuk gjendet në shkresat e lëndës.

33. Gjithashtu lidhur me të pandehurin **F.A.**, mbrojtja kundërshton se gjykata e shkallës së parë ka bazuar aktgjykimin e saj vetëm në dëshminë e të bashkëpandehurit **F.M.** dhe në raportet e përgjimit të telefonatave dhe siç është cituar nga gjykata këto nuk ofrojnë prova të mjaftueshme kundër të pandehurit

34. Lidhur me të pandehurin **F.A.**, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh se emri i të pandehurit nuk është përmendur asnjëherë nga të bashkakuzuarit e tjerë gjatë marrjes së tyre në pyetje. Për më tepër, gjykata në aktgjykimin e saj nuk ka marrë asnjë qëndrim në lidhje me qëllimin e mundshëm të të pandehurve për kryerjen e krimit në fjalë.

35. Po ashtu Mbrojtja e **S.B.t** ka theksuar se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka marrë parasysh sa duhet se sipas vetë të pandehurit ai asnjëherë nuk kishte folur me asnjërin nga t pandehurit e tjerë dhe se asnjëherë nuk është vlerësuar qëllimi i mundshëm i të pandehurit për të marrë pjesë në kryerjen e krimit.

36. Gjykata Supreme e Kosovës përkitazi me këtë i referohet asaj çka u shtjellua tanimë në pikën A. të këtij Aktgjykimi lidhur me faktin se pothuajse e vetmja provë e potencuar nga Gjykata e Shkallës së Parë është dëshmia e **F.M.t** e dhënë në polici më 10 qershor 2008 dhe se shënimet e përgjimeve telefonike të cituara nga Gjykata së paku nuk janë prova shumë të fuqishme vërtetuese duke marrë parasysh se përmbajtjet e bisedave përkatëse telefonike nuk janë të njohura. Gjykata Supreme përveç kësaj vërteton se Gjykata e Shkallës së Parë në Aktgjykimin e kundërshtuar të saj vërtetë nuk ka analizuar fare dëshmitë dhe provat kundërthënëse, por – me sa duket duke argumentuar vetëm në bazë të pretendimeve të ngritura në aktakuzë – ishte e interesuar vetëm të gjejë ndonjë alibi si shfajësim të mundshëm për të pandehurit. Vetëm dy herë Gjykata e Shkallës së Parë ka dhënë disa arsye për të besuar ose për të mos besuar një dëshmi të caktuar. Sa i përket dëshmisë së dëshmitares A.L. dhe D.P., Gjykata pohoi se nuk ekzistonte “*asnjë arsye për të dyshuar në besueshmërinë e dëshmitarëve [...] pasi që dëshmitë e tyre kishin qenë plotësisht të qëndrueshme*”, por megjithatë dhe pa arsyetim të mëtutjeshëm e shpalli të pandehurin **H.I.** “*fajtor jo për atë se ka hyrë në bankë por se ka organizuar dhe mbështetur grabitjen*” (f.22 e versionit në gjuhën Angleze). Si dhe, dëshmia e dytë e të pandehurit **F.M.** e dhënë më 17 korrik 2008 përpara Prokurorit Publik, nuk ishte konsideruar si e besueshme (f.28-29 e versionit në gjuhën Angleze), por nuk ishte kundërshtuar në këtë situatë.

37. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se vlerësimi dhe analiza e dëshmive siç është kryer nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe paraqitur në Aktgjykimin e kundërshtuar nuk është aq i kujdesshëm dhe i hollësishëm sa mund të pritet në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira Evropiane. Prandaj, është vërtetuar edhe shkelja e Nenit 405 të KPPK-së.

38. Megjithatë, siç është potencuar në shumë lëndë, siç është lënda kundër J.K. etj., Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk është as në kompetencë të kolegjit të ankesave e as nuk është e mundur të bëhet ndërrimi i gjetjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë me ato të sajat, sidomos pa i marrë të gjitha provat përsëri. Në lëndën *Runjeva, Axhami dhe Dema* (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 më datë 25 janar 2008, faqe 20), Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka theksuar se “*procedura ankimore në KPPPK qëndron në parimet që gjykata duhet të dëgjojë, vlerësojë dhe peshojë provat në gjykim [ ... ]. Prandaj, gjykata e shkallës së dytë kërkohet t’i japë gjykatës së shkallës së parë lirinë e vlerësimit në arritjen e gjetjeve faktike. Nuk duhet t’i trazojë gjetjet e gjykatës së gjykimit dhe t’i zëvendësojë me të vetat, përveç nëse provat mbi të cilat mbështetet gjykata e gjykimit nuk kanë mundur të pranohen nga asnjë gjykatë e arsyeshme ku vlerësimi i saj ka qenë ‘tërësisht i gabuar’* “. Prandaj si rregull, kjo Gjykatë nuk do të shtjellojë mbledhjen e provave dhe duke u bazuar në këtë as detajet e gjetjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë.

39. Pasi që në këtë lëndë Aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së parë jep përshtypjen se Gjykata nuk ka vlerësuar drejt dhe në tërësi të gjitha provat në dispozicion dhe të nevojshme, duhet të bëhet një vlerësim i drejtë i provave përkitazi me të gjitha provat e pranueshme në dispozicion. Megjithatë, kjo do të duhej të bëhej gjatë procedurës paraprake, pra nga Gjykata e shkallës së parë.

#### **D. Shkelja esenciale e ligjit penal**

40. Avokatët mbrojtës të të pandehurve **S.B.**, **H.I.**, **B.B.** dhe **F.A.** më tutje kundërshtuan Aktgjykimin e shkallës së parë mbi pretendimin e shkeljes së ligjit penal, në përputhje me Nenin 402 paragrafin 1 pika 2 lidhur me Nenin 404 të KPPK-së. Në të gjitha lëndët Mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar asnjë provë për pjesëmarrjen e klientëve të tyre në veprat penale përkatëse sipas aktakuzës.

41. Gjykata Supreme e Kosovës vërtetë gjen se Gjykata e shkallës së parë ka thyer parimin e supozimit të pafajësisë mbrapsht, kur përfundoi se i pandehuri është fajtor vetëm për shkak se nuk ka alibi. Veçanërisht sa i përket të pandehurit **H.I.** (f.22 e versionit në gjuhën Angleze) Gjykata e shkallës së parë – pasi ka cituar disa pjesë të dëshmisë së dëshmitarëve A.L. dhe D.P., ku të dytë pohuan se takuan të pandehurin, por një copë kohe pas grabitjes së bankës – vërtetoi se “[Gjykata nuk ka arsye të dyshojë në besueshmërinë e dëshmitarëve [...] pasi që dëshmitë e tyre kanë qenë plotësisht të qëndrueshme [dhe se] rrethanat që H.I. vërtetë kaloi një kohë prej orës 11:00 deri 14:00 në shoqërinë e tyre nuk përbën alibi sa i përket akuzave kundër tij. Gjykata nuk e shpall të pandehurin fajtor për hyrje në bankë por për organizim dhe mbështetje të grabitjes”. Pavarësisht nga dëshmia e të bashkëpandehurit **F.M.** të referuar edhe më parë, asnjë arsyetim i mëtutjeshëm nuk është dhënë lidhur me pyetjen, pse Gjykata ishte e bindur për fajësinë e të pandehurit. Në vend të kësaj, Gjykata hyn në spekulime përkitazi me përmbajtjet e pretenduara të bisedave telefonike në mes **S.B.t** dhe **H.I.t**, duke pohuar se “[ë]shtë e qartë, përkundrazi, se thirrjet telefonike që u bënë gjatë mbrëmjes së 8 qershorit 2009 në mes **H.I.** dhe **S.B.** ishin në lidhje me sigurimin e veturës nga ky i fundit për grabitjen e bankës në ditën vijuese” (f.24 e versionit në gjuhën Angleze). Nga arsyetimi e as nga shkresat e lëndës nuk mësohet se si Gjykata e shkallës së parë ka mundur të dijë për përmbajtjet e bisedave telefonike përkatëse. Prandaj Gjykata Supreme gjen se vargu i argumenteve nga Gjykata e shkallës së parë në kontekstin e dhënë paraqet një shkelje të rëndë të ligjit material.

42. S ai përket shkeljeve të tjera të ligjit penal, Gjykata Supreme e Kosovës i referohet asaj çka u tha më herët nën pikat A. dhe B. të këtij Aktvendimi, ku u vërtetua se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt të gjitha provat e nevojshme ose së paku nuk i ka shtruar gjetjet e saj në Aktgjykim në mënyrë që të mund të përputheshin me ligjin dhe me standardet dhe praktikat më të mira Evropiane. Prandaj, Gjykata Supreme në situatën e dhënë nuk mund të marrë qëndrim në pyetjen se a ka shkelje tjera të ligjit penal të bëra nga Shkalla e parë, pasi që rezultatet përkitazi me këtë varen nga vërtetimi i plotë dhe i drejtë i fakteve nga gjykata e shkallës së parë – bazuar në këtë – nga vlerësimi i drejtë ligjor i fakteve nga ajo Gjykatë.



## **E. Vendimi mbi dënimin**

43. Të gjithë Avokatë mbrojtës si dhe Prokurori Publik i Qarkut siç u konfirmua me mendimin e ZPSHK-së kanë kundërshtuar Aktgjykimin e shkallës së parë edhe për vendimin mbi dënimin përkitazi me të gjithë të pandehurit. Gjersa Mbrojtja pretendon se vetëm lirimi i të pandehurve do të ishte vendim i duhur, Prokuroria kërkon një dënim më të rëndë në të gjitha lëndët.

44. Po ashtu përkitazi me këtë Gjykata Supreme e Kosovës nuk mund të marrë qëndrim në situatën e dhënë, pasi që shqiptimi i dënimit të duhur varet nga gjetjet lidhur me përgjegjësinë penale të secilit të pandehur dhe – siç është theksuar më herët – nga gjetjet faktike të vërtetuara pa gabime nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Për arsyet e përmendura më lart Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**Ap.-Kž. Nr. 377/2009**  
**10 maj 2011**  
**Prishtinë**

### **Anëtarët e kolegjit:**

---

Antoinette Lepeltier-Durel  
Gjyqtare e EULEX-it

---

Marije Ademi  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Nesrin Lushta  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Emine Mustafa  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

### **Kryetar i kolegjit:**

---

Gerrit-Marc Sprenger

Gjyqtar i EULEX-it

**Procesmbajtës:**

---

Holger Engelmann  
Zyrtar Ligjor i EULEX-it